



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
01Nr. 104/02-14800/19
Kaçanik, 30.05.2019

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.104/02-14800/19, të datës 17.05.2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur më 30.05.2019, mori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË
SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1.Me këtë vendim, formohet Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve dhe atë: 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, 2 anëtarë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtar nga Sektori joqeveritar, si vijon:

1. Kadri Krivenjeva, anëtar i Kuvendit të Komunës,
2. Kaltrina Tafili, anëtare e Kuvendit të Komunës,
3. Remzi Shabani, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës,
4. Besnik Bajra, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës dhe
5. Zekirja Elezi, anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të përcaktuar si në pikën 2 të këtij vendimi.

3. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi, Detyrat dhe Përgjegjësitë dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e tij do të bazohet në nenin 17 pika 4 e Ligjit Nr. 06/L-092 – Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës si dhe ne aktet nënligjore që do t'i nxjerr Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

4. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi, do t'i shqyrtoj çështjen e pronave për të cilat janë marrë vendime paraprake për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale të cilat janë në procedurë, ndërkaq për rastet tjera të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale, formohen komisione të tjera vlerësuese.

5.Organet relevante të administratës dhe njësitë tjera të organeve të saj, do t'i ofrojnë përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

6. Me miratimin e këtij Vendimi, Shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-8499/18- Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i datës 30.03.2018 si dhe Vendimi 01Nr. 104/02-2312/19- Për Ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës i datës 24.01.2019.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik.

8. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL , si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Datë: 10/06/2019 Nr.020-643
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 01 Nr. 104/02-14800/19 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

I miratuar më datë: 30/05/2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06/06/2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislationit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.